**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**
**Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik**
**“Koço Gliozheni” Tiranë**

Nr________Prot                                         Tiranë, më ___/___/2024

# SPECIFIKIMET TEKNIKE

**INSTITUCIONI: Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni” Tiranë**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i Lavanterisë për SUOGJ “Koço Gliozheni”, me afat MK 36 muaj.**

**<u>Specifikimet teknike të Menaxhimit të Proçesit të Lavanderisë</u>**

1. Operatori ekonomik do të ofrojë shërbimin e tij, nga proçesi i lavanderisë deri tek kompletimi me inventarin e materialit të butë shtrimin/nderrimin e materialeve ne shtratin e pacientit/shtratin e mjekut roje.

2. Sipërmarrësi është i detyruar të disponojë të gjitha kapacitetet larëse dhe dezinfektuese, tharëse, hekurosëse dhe paketuese. Përveç kësaj, sipërmarrësi duhet të sigurojë për zëvendësimin e materialit të butë, nëse është i dëmtuar apo i amortizuar (sipas kohës së tyre të amortizimit dhe sipas nevojes).

3. Sipërmarrësi siguron inventarin e materialit të butë të nevojshëm, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratit që ka **Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni” Tiranë,** me emërtimin/siglën përkatëse të institucionit kontraktues me qendisje, datën e futjes së materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.

4. Sipërmarrësi do të lajë, dezinfektojë, thajë, paketojë, të transportojë dhe shpërndajë deri në pavion bazën e materialit të butë, si dhe të bëjë shërbimin e plotë deri tek shtrati i pacientit.

5. Rregullat e shtrimit të shtratit do të bëhen, sipas protokolleve të kujdesit infermieror, manualit të kujdesit spitalor, rregullave të higjienës me njoftimin e hapjes së kartelës së re të shtrimit nga K/mamisë se shërbimit, si dhe sa herë të nevojitet nga shërbimi.

6. Larja dhe dezinfektimi, në repartin e lavanderisë do të bëhet në mënyrë të përqëndruar, duke respektuar të gjitha proçedurat dhe protokollet e higjienës, nga marrja në dorëzim e materialit të butë të papastër të ndarë sipas nëndarjeve dhe zonave të rrezikshmërisë (thasët me ngjyrë), tek dorëzimi i materialit të butë, të larë, të hekurosur dhe të paketuar sipas këtyre protokolleve, deri në shtrimin e shtratit të pacientit sipas protokolleve mjeksore.

7.Procesi i lavanderise do te realizohet ne ambientet e operatorit ekonomik , ambientet te jene te vetat ose me qera .

8-Operatori i kontraktuar duhet të ofrojë shërbimin e grumbullimit të të gjithë materialit të butë të papastër në bazë të rregullores së parandalimit te infeksioneve

nozokomiale, transportimin e tij në lavanderi, seleksionimin, larjen, hekurosjen, paketimin, transportimin sërisht mbrapsht në Shërbime (ku materiali i larë nuk duhet të ketë kontakt me materialin e palarë për te shmangur infeksionet) , deri në shtrimin e shtratit te pacientit gjate 24 oreve për 7 (shtate) ditët e javes .

9- Punësimin e mjaftueshem të personelit për ofrimin e shërbimit:

10-Duke pasur parasysh natyren spitalore, është e domosdoshme dhe e rëndesishme, që materiali i butë per t'u larë duhet të tërhiqet sa më shpejt nga pavionet ose sallat e operimit , bazuar ne manualet e kujdeseve spitalore dhe rregullave të higjenës (selektimi sipas ndotjes së materialit të bute ne thasët me ngjyrë). Moslargimi në kohë i këtij materiali, do të conte në rritjen e infeksioneve spitalore me efekt final uljen e performances se ofrimit të shërbimit ndaj pacientëve, rritjen e ditëqëndrimit

- Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ”Koço Gliozheni” Tiranë, sipas grafikëve të përcaktuar, rregullave dhe protokolleve të higjenës dhe manualeve të kujdesit spitalor;

- Larjen e materialit të butë;

- Hekurosjen dhe Paketimin e materialit të butë;

- Shpërndarjen e materialit të butë në të gjithë shërbimet e Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik”Koço Gliozheni” Tiranë, sipas grafikëve të përcaktuar;

- Shtrimin e shtratit të pacientit;

- Sigurimin e materialit të butë për shtratin e pacientit, personelin shëndetësor si dhe për sallat operatore sipas specifikimeve përkatëse materiali I butë do të ketë të qëndisur logon e **Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ”Koço Gliozheni” Tiranë, bazuar në Udhëzimin me Nr. 141 datë 08.03.2024 (bashkëlidhur).**

***KUJDES**

**Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.**

Sherbimi do te ofrohet gjate gjithe javes prej dites se hene deri diten e diel (operatori ekonomik privat, duhet te siguroje edhe materialin e bute per mbulimin e nevojave ne pavione, dhe shtrimin e shtratit te pacientit gjate fundjaves) si dhe lenien e bazes materiale rezerve per nevoja te sherbimit gjate shtrimeve te reja naten, urgjencave, por edhe sipas grafikut te percaktuar per nderrimin periodik te materialit te bute ne sherbimet perkatese, dhe sipas kerkeses se Kryemamive/infermiereve te pavionit ne rast te nderrimit te materialit te bute kur behet i domosdoshem per paciente te vecante.

Tërheqja dhe dorëzimi i inventarit të materialit të butë në pavione, do të bëhet me grafik të hartuar nga Sektori i Sherbimeve te Hotelerise së Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik"Koço Gliozheni" Tiranë. Grafiku është i detyruar të zbatohet nga të dyja palët, dhe në rastet e ndryshimit të tij, miratimi duhet të bëhet me nënshkrim po nga të dyja palët. Përdorimi i inventarit të materialit të butë brënda pavionit, bëhet dhe mbetet nën përgjegjësinë e personelit të sipërmarrësit të kontrolluar nga autoriteti kontraktor, sipas proçedurave të mëposhtme:

**<u>Arsyetimi mbi afatin 3- vjeçar për këtë shërbim kontraktual.</u>**

Referuar në pikën 3, Neni 76 "Kohëzgjatja e kontratës" të Kreut IX, te VKM Nr.914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" ku theksohet se:

Vetëm në rrethana të argumentuara, të shpallura në njoftimin e kontratës, që lidhen ngushtësisht me natyrën, kompleksitetin dhe financimin e saj, autoriteti kontraktor mund të lidhë një kontratë shumëvjecare, nëse:

- është kontratë komplekse, që kërkon financim shumëvjeçar ose të strukturuar, e cila nuk mund të zbatohet brenda vitit ushtrimor (si për shembull, projektet komplekse në infrastrukturë) dhe ku financimi i saj është i garantuar.

Kontrata që kërkohet të lidhet ka një natyrë të veçantë, pasi nëpërmjet saj synohet te ofrohet shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar dhe ambulator në shërbimet e Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik"Koço Gliozheni" Tiranë

Duke patur parasysh natyrën spitalore, është e domosdoshme dhe e rëndësishme, që materiali i butë për t'u larë, duhet të tërhiqet sa me shpejt nga pavionet ose sallat e operimit, bazuar në manualet e kujdesjeve spitalore dhe rregullave të higjienës (selektimi sipas ndotjes së materialit të butë në thasët me ngjyrë). Moslargimi në kohë i ketij materiali, do të çonte në rritjen e infeksioneve spitalore me efekt final uljen e performacës së ofrimit të shërbimit ndaj pacientëve, rritjen e ditëqendrimit, rritjen e përdorimit të medikamenteve (kryesisht antibiotikeve).

Operatori ekonomik privat që do të kontraktohet, duhet të ofrojë një sherbim, i cili do të përfshijë:

- Grumbullimin e materialit te bute te papastër në të gjitha shërbimet e Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik"Koço Gliozheni" Tiranë., sipas grafikeve te percaktuar, rregulloreve dhe protokolleve te higjenes dhe manualeve te kujdesit spitalor;
- Larjen e materialit te bute;
- Tharjen e materialit të butë,
- Hekurojen dhe paketimin e materialit te bute;
- Shperndarjen e materialit te bute ne te gjitha sherbimet dhe shërbimet e Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik"Koço Gliozheni" Tiranë, sipas grafikeve te percaktuar;

- Shtrimin e shtratit te pacientit;

Në kontratën e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë, ndër të tjera duhet të ketë disa elementë kryesorë, si:

I. Larjen e materialeve të buta.
II. Specifikimet Teknike të materialit të butë.
III. Etapat e Menaxhimit të proçesit të Lavanderisë.
IV. Termat e Referencës
V. Process-verbali I materialit të butë (mostrave) duke përcaktuar peshat dhe përmbushjes së specifikimeve teknike sipas kërkesave të AK shoqëruar me çertifikatën e cilësisë së produktit.

Referuar të dhënave elektronike të dërguara nga shërbimi i statistikës me Nr. 350 Prot, date 12.04.2024. Ky eshte numri i shtreterve mbi të cilën llogaritet aktiviteti spitalor të hospitalizuar dhe ambulator, të cilët marrin shërbimin e duhur. Kjo, në mënyrë që mos të bëjmë fryrje të kërkesës duke sjellë shpenzime më të larta.
Gjithashtu në parashikim do të futen edhe shtreterit e mjekeve roje, që sipas shkresës me Nr.351/15 Prot, datë 18.04.2024 është 7 mjekë roje informacion nga Sektori i Burimeve Njerëzore, shkresa me Nr. 350 Prot, datë 12.04.2024 nga Sektori I Statistikës, shkresat për numërin e shtretërve me Nr. 351/13 datë 18.04.2024, 351/14 datë 18.04.2024, nga K/Mami e përgjithshme dhe K/Mamitë e Shërbimeve në SUOGJ "Koço Gliozheni", shkresë me Nr. 373 Prot, date 23.04.2024 "Propozim mbi etapat që do të ndiqen çdo ditë për procesin e shërbimit të lavanterisë".

***Nevojat e SUOGJ "Koço Gliozheni" për shërbimin e lavanterisë.***

**Tabela 1. Numri i shtreterve qe do te marrin sherbim ne Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik"Koço Gliozheni" Tirane për pacient të Hospitalizuar.**

| **Pershrkimi i Sherbimit** | **Nr. Shtreterve** |
|---|---|
| Shtreter per sherbimet e Gjinekologjisë | 24 |
| Shtreter per sherbimin e Reanimacioneve | 4 |
| Shtreter per sherbimin Obstetrikës (janë pershfshire repartet lehonia 1, Lehonia 2) | 55 |
| Shtreter per Patollogjine e shtatzanise | 29 |
| Shtreter per Urgjencë Pranimin (ne te cilin perfshihet edhe dhomat e manipulimit) | 6 |
| Shtretër neonat/terapi intensive neonati | 45 |
| Shtretër në total adult | 163 |

Numëri I shtretërve të vizitave ambulatore, të ekografive, mjekëve roje:

- Qëndra e Shëndetit të Gruas 6 (gjashtë) shtretër vizitash
- Pranim – Urgjenca 1 (një) shtrat vizitë ekografie
- Shërbimi I Gjinekologjisë 1 (një) shtrat vizitë ekografie
- Shërbimi I Patologjisë 3 (tre) shtrat vizitë ekografie
- Klinika e lehonisë 1 (një) shtrat mjekimi
- Klinika e lehonisë 1 (një) shtrat mjekimi
- Terapi intensive 4 (katër) shtretër izolimi neonat
- Qëndra e Riprodhimit të Asistuar Mjeksor 2 (dy) shtretër pacienti ambulatory

- **Mjek Roje 7 (shtatë)**

Në rast nevojash, shtim shtretërish prej ndonjë emergjence, apo epidemi vendi, apo forca madhore, numri shtretërve do të rritet. Për këtë duhet mbajtur sasi gjendje materiali të butë.
Nga sa më sipër nr total i shtreterve qe duhet te pajisen me baze material dhe qe duhet te jene te mbuluar nga sherbimi i lavanderise eshte afërsisht **170 shtretër:**

Referuar standardeve dhe protokollove për shërbimet spitalore, në vijim janë të detajuar lloji i materialit të butë që do të kete per secilin pacient dhe qe do te lahet si dhe materiali i bute per personelin mjeksor.

Ndërrimi i shtratit të pacientit do të bëhet çdo tre ditë ose dy herë në javë, si dhe në çdo rast që kërkohet nga kryeinfermieri i pavionit/shërbimit, si pasojë e shtrimit të pacientëve të rinj (me hapjen e kartelës klinike), ose në rastet kur ndryshimi i shtratit bëhet i domosdoshëm për të ruajtur dhe mbrojtur shëndetin e pacientit.

Në tabelën në vijim, jepet e detajuar shpeshtësia e ndërrimit të çarçafëve, në disa prej shërbimeve në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik"Koço Gliozheni" Tiranë, si dhe tabela e parashikimit të larjes së materialeve të buta gjatë kësaj periudhe:

**<u>Tabela : Sasia ne kg e kerkuar per tu prokuruar</u>**

| **Nr.** | **Pershkrimi i sherbimeve** | **Njesia** | **Sasia e larjeve te kerkuara per 36 muaj (kg)** |
|---|---|---|---|
| **I** | Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise ne Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik"Koço Gliozheni" Tiranë (**larja,dezinfektimi,tharja,paketimi ,transporti si edhe nderrimi i shtratit te pacientit .)** | Kg | **452,894.52** |

**<u>Shënim: Sasia në Kg është parashikuar në konsumin mesatar mujor (të 31 muajve) sipas kontratës në fuqi MK me afat 36 muaj.</u>**

**Pervec larjes operatori duhet te riperterije menjehere me lidhjen e kontrates materialin ekzistues sipas tabeles se meposhtme**:

| Materiali I kërkuar dhe që i mbeten në perdorim S.U.O.GJ ”Koço Gliozheni” Tiranë | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emertimi** | **Njesia** | **Sasia** | **Normativa e Perdorimit për materialin e butë jemi bazuar në udhëzimit Nr.141 date 08.03.2024.** | **Data e Hyrjes ne S.U.O.GJ ”Koço Gliozheni” Tiranë** |
| 1 | Jorgane me vatine | Cope | **200** | 5 vjet | Sipas kërkesave të AK |
| 2 | Jasteke | Cope | **215** | 5 vjet | Sipas kërkesave të AK |
| 3 | Kellef Jasteku | Cope | **645** | 1 vit | 2024 |
| 4 | Kellef (Mbrojtese )Dysheku I Gomuar | Cope | **350** | 2 vjet | 2024 |
| 5 | Batanije | Cope | **240** | 5 vjet | Sipas kërkesave të AK |
| 6 | Batanije Dimerore Neonate dhe prematurë | Cope | **260** | 5 vjet | Sipas kërkesave të AK |
| 7 | Carcaf i siperm dysheku | Cope | **510** | 1 vit | 2024 |
| 8 | Carcaf i poshtem dysheku | Cope | **510** | 1 vit | 2024 |
| 9 | Çarçafë zarf | Cope | **400** | 1 vit | 2024 |
| 10 | Peshqirë (pacienti, personeli, urgjence, kabineti) | Cope | **320** | 1 vit | 2024 |
| 11 | Pelena | Cope | **1000** | 1 vit | 2024 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 12 | Peceta kirurgjie 75x90, Traversa | Cope | **1000** | 1 vit | 2024 |
| 13 | Kemisha grash | Cope | **150** | 1 vit | 2024 |
| 14 | Rrobdishan Pacienti Adult | Cope | **60** | 2 vjet | 2024 |
| 15 | Pandofla (per mjek/infermieror/mami dhe sanitar) | Cope | **250** | 2 vjet | 2024 |
| 16 | Perparese mjeku ( Unisex ) Ngjyra e bardhë. | Cope | **120** | 1 vit | 2024 |
| 17 | Kostume infermier (neonati) ( bluzë me pantallona unisex ) (gjatë dimrit vishet bluzë e bardhë me mengë të gjata poshtë kostumit) | Cope | **60** | 1 vit | 2024 |
| 18 | Kostume infermier salle operatore/blloku operator/ **mami** ( bluzë me pantallona unisex ) (gjatë dimrit vishet bluzë e bardhë me mengë të gjata poshtë kostumit) | Cope | **322** | 1 vit | 2024 |
| 19 | Kostume mjeku ( bluzë me pantallona unisex ) (gjatë dimrit vishet bluzë e bardhë me mengë të gjata poshtë kostumit) | Cope | **120** | 1 vit | 2024 |
| 20 | Kostume sanitare( bluze me pantallona unisex ) gjate dimrit vishet bluze e bardhe e menge te gjata poshte kostumit | Cope | **110** | 1 vit | 2024 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 21 | Kostume personel ndihmes ( bluzë me pantallona unisex ) (gjatë dimrit vishet bluzë e bardhë me mengë të gjata poshtë kostumit) | Cope | **10** | 1 vit | 2024 |
| 22 | Kostum recepsionist /Informacioni ( bluzë me pantallona unisex ) (gjatë dimrit vishet xhakete e zeze ose triko e zeze) | Cope | **12** | 1 vit | 2024 |
| 23 | Dyshek spitalor | Cope | **170** | 5 vit | Sipas kërkesave të AK |

***Materiali i bute qe do te blihet , do te lahet dhe zevendesohet sipas kushteve të mësipërme bazuar në*** Udhëzimin Nr. 141 Prot, datë 08.03.2024 dërguar nga MSHMS

**Etapat e këtij proçesi çdo ditë:**

- Çdo ditë Kryemamise të sherbimit ose personi i autorizuar prej saj, përpilon, siglon dhe dorëzon, kërkesën, për ditën e nesërme për material të butë, duke cilësuar numrin shtrimeve të reja, të cilën e dorëzon brënda orës 12:00 tek Sektori i Sherbimeve të Hotelerisë të Spitalit.

- Shefi/Sektorit të Sherbimeve te Hotelerise të Spitalit, në bazë të kërkesave ditore dhe grafikut të pavioneve, harton evidencën ditore përmbledhëse ne total per gjithe Spitalin, dhe ia dorëzon sipërmarrësit brënda orës 13:00 për ditën pasardhëse.

- Peshimi dhe numërimi i materialit të butë të larë, të thatë, të hekurosur, si dhe të paketuar do të bëhet çdo ditë në ambjentet që do caktohen nga Autoriteti Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës, çdo ditë në orën 08:00 nën prezencën e përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesit të sipërmarrësit, duke mbajtur proçes-verbalin përkatës të firmosur nga palët. Ky dokument do ketë vlerë financiare, pasi likuidimi i operatorit ekonomikë do të bëhet mbi bazën e proçes verbaleve të nënshkruara nga palët për çdo ditë.
- Vetëm pasi të jetë peshuar dhe numëruar, materiali i butë është gati për tu shpërndarë nga Sipërmarrësi në shërbimet përkatëse, sipas kërkesave të shërbimit të bërë një ditë më parë.
- **Shpërndarja e materialit të butë** në pavione, do të bëhet nga sipërmarrësi çdo ditë pas orës 08:00 deri në orën 15.00, sipas grafikut të përpiluar nga Sektori i Sherbimeve te Hotelerise dhe miratuar nga palët.

- Sipërmarrësi ia dorëzon materialin e butë **Kryemamise të sherbimit** në bazë të grafikut të hartuar nga Shefi/Sektorit të Sherbimeve të Hotelerise. Për çdo rast, dorëzimi i materialit të butë do të bëhet vetëm pasi ky material i butë të jetë peshuar, numëruar dhe në momentin e dorëzimit do të mbahet proçesverbali i dorëzimit (ne kilograme) i firmosur nga të dyja palët, nga grupi i pritjes se mallit si dhe nga Kryeinfemieri i Pavionit/Shërbimit përkatës, në 3 (tre) kopje. Kryeinfermieri i pavionit dhe Grupi i pritjes se mallit bën kontrollimin për larjen,hekurosjen, cilësinë e materialit të butë dhe në rast konstatimi të materialit të butë difektoz ose të papastër, e kthen mbrapsht duke e pasqyruar në proçesverbal. Ky proçesverbal duhet të ketë të saktësuar numrin e materialit të butë të marrë në dorëzim nga Krye/infermieri i pavionit.

- Kryemamise të sherbimit  ose personi i autorizuar prej saj se bashku me grupin qe pret mallin, do të evidentojnë dhe konfirmojnë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me shërbimin që kryhet, cilësinë dhe sasinë e kërkuar, si dhe për çdo parregullsi do të konfirmojne dhe informojne me shkrim në Sektorin eSherbimeve te Hotelerise te Spitalit.

- Tërheqja e materialeve të buta të ndotura nga pavioni, do të bëhet nga sipërmarrësi deri në orën 15.00, duke iu referuar rregullores në parandalimin e infeksioneve spitalore.

- Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës, prej ditës së hënës deri ditën e dielë, (operatori ekonomik duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në pavion, dhe shtrimin e shtratit të pacientit, gjatë fundjavës) gjatë 8 orëve, ndersa per Sherbimet e Urgjences e Reanimacionit do te jete 24-oresh , edhe sipas kërkesës së **Kryemamise të sherbimit** në rast të ndryshimit të materialit të butë bëhet i domosdoshëm për pacientë të veçantë.

- Në të gjitha rastet, kur shërbimet kanë nevoja për material të butë shtesë, vetëm pas miratimit të kërkesës së shefit të shërbimit nga Sektori i Sherbimeve te Hotelerise, Sipërmarrësi do të proçedojë me dorëzimin e materialit të butë shtesë, të kërkuar nga shërbimi.

- Në raste të konstatimit të mungesave dhe/ose dëmtimit të materialit të butë për periudhën e lënë nën administrim e personelit të Spitalit , do të mbahet një procesverbal, të firmosur nga të dyja palët, një kopje e të cilit do të dorëzohet në sektorin e Sherbimeve te Hotelerise dhe sipërmarrësi do të bëjë menjëherë zëvendësimet përkatëse.

- Riparimi i materialit të butë të dëmtuar, bëhet nga sipërmarrësi duke ruajtur përmasat, dimensionet, përbërjen fillestare (të gjitha specifikimet teknike të materialit të butë).

- Sipërmarrësi detyrohet të zëvendësojë materialin e butë të vjetëruar në përdorim me material të butë të ri sipas jetëgjatësisë së çdo materiali të butë dhe sipas nevojes.

- Në të gjitha rastet kur sipërmarrësi dhe/ose autoriteti kontraktor konstatojnë material të butë të dëmtuar, të dy palët mbajnë një proçes verbal dhe më pas proçedohet me nxjerrjen nga përdorimi të këtij materiali të butë.

- Për raste të gjendjes së jashtëzakonshme, epidemive apo pandemive, lavanderia do të  funksionojë sipas kushteve që do të vendos Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik ”Koço Gliozheni” Tiranë.

- Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kontrollojë në prani të përfaqësuesit të sipërmarrësit, dhe të përpilojë akt kontrolle nga sektorë të ndryshëm të saj, në bazë të programeve të punës, për të evidentuar çdo parregullsi në lidhje me kryerjen e shërbimit, sasinë e materialit të butë të dorëzuar duke rakorduar dhe mbajtur procesverbale përkatëse të shërbimit.

- I gjithë materiali i butë në përdorim, me përfundimin e kontratës, i dorëzohet Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik”Koço Gliozheni” Tiranë pa kundërpagesë.

- Të gjitha kostot për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë në **Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik”Koço Gliozheni” Tiranë** do të sigurohen nga vetë sipërmarrësi.

- Marrëdhëniet financiare midis palëve, do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës.

- Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik"Koço Gliozheni" Tiranë likujdon çdo muaj Sipërmarrësin, bazuar në sasinë e materialit të butë të thatë në kilogramë sipas proçesverbaleve ditore të peshimit,permbledheses mujore te larjes ne kilograme te hartuar nga grupi i punes ,si edhe përmbledhëses mujore te kerkesave te krye/infermiereve sipas forcës së pavionit, të hartuar nga Sektori i Sherbimeve te Hotelerise dhe të miratuar nga të dyja palët.

- Kur sipërmarrësi nuk bën ndërrimet e materialit të butë të shtratit të pacientit sipas afateve të përcaktuara, me ankesën me shkrim të shërbimit/pavionit, përfaqësuesi i Spitalit përpilon informacionin përkatës duke i bashkëngjitur një proçes – verbal, në bazë të të cilit vërtetohet se nuk është kryer shërbimi. Për çdo ditë, shtrati që nuk është ndërruar në afat, sipërmarrësi i mbahet vlefta e llogaritur e materialit të butë të thatë që nuk është ndërruar. Në rastet kur mungesa e shërbimit përsëritet, sipërmarrësi i paguan gjobë Spitalit , sa dhjetëfishi i vlerës së shërbimit të munguar të llogaritur në shërbim.

- Proces – verbalet për ndalesat dhe gjobat, i mbahen sipërmarrësit në pagesën mujore të radhës. Ato mund të kundërshtohen nga sipërmarrësi në Drejtorinë e **Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik"Koço Gliozheni" Tiranë** brënda muajit (30 ditë) vijues. Jashtë këtij afati, këto proçese do të quhen të pranuara nga palët.

- Personeli që punësohet nga sipërmarrësi në shërbimin e lavanderisë, brenda territorit të Spitalit, është i detyruar të zbatojë protokollet e kujdesit të higjienës, të kujdesit mjeksor, si dhe rregulloren e Spitalit. Në rastet kur kjo shkelet, punonjësi përkatës largohet nga puna nga sipërmarrësi me kërkesën me shkrim të Drejtorisë së Spitalit, informacionit dhe proçes verbalit përkatës.

Kontrata do te kete elemente kryesore: Larjen e materialeve te bute.

**Sasia e materialeve te buta per larje:**

Materiali i bute qe do te lahet nga operatori ekonomik, grupohet ne 4 (katër) kategori:

- Material i bute per pacientet
- Materiale i bute per sallat e operacionit dhe sallat lindjes
- Matrial i bute per personelin
- Material i butë për Neonatin

Ne vijim do te jepen te detajuar lloji i materialit te bute qe do te lahet per sejcilen nga kategorite e siperpermenduar, si dhe perllogaritja e sasise se materialit qe do te lahet mbi bazen vjetore, javore e ditore.

1. **Per sa i perket materialit te bute per paciente operatori ekonomik duhet te laje keto materiale:**
    - Carcafe shtrati (i poshtem, i siperm)
    - Carcaf zarf
    - Kellef jastiku
    - Jastek krevati
    - Kemisha grash
    - Robdishan pacienti
    - Jorgan me vatine
    - Kellef dysheku i gomuar
    - Batanije Dimerore

- Tranversa
- Pelena
- Batanije bebe neonati
- Batanije bebe prematur

2. **Materiali i bute per sallat e operacionit:**

- Kostume
- Perparese kirurgu
- Carcaf shtrati (i poshtem, i siperm)
- Pelena
- Peshqire
- Batanije
- Pandofla salle
- Kompresa operacioni/Garza barku jo sterile

3. **Materiali i bute per stafin mjekesor:**

- Perparese per mjeke/ infermier/personel i ndihmes
- Kostume per mjeke/ infermier/personel i ndihmes
- Peshqire per mjeke/ infermier/personel i ndihmes
- Pandofla

Nderrimi i shtratit te pacientit do te behet çdo tre dite dhe sa herë të jetë e nevojshme, si dhe ne çdo rast qe kerkohet nga Kryeinfermierja/Kryemamia e Shërbimit/Pavionit, si pasoje e shtrimit me paciente te rinj ose ne rast kur nderrimi i shtratit behet i domosdoshem per te ruajtur dhe mbrojtur higjenën/shendetin e pacientes. Gjithsesi, ne sherbime te vecanta ky nderrim do te kryhet sa here te jete i nevojshem.

Duke pasur parasysh shperndarjen aktuale te shtreterve sipas sherbimeve te ndryshme si dhe perqindjen e shfrytezimit te shtratit sipas sherbimeve, tabela ne vijim jep nje pamje te numrit te shtreterve te cilat jane te domosdoshme per tu kompletuar me inventar te bute nga ana e opertaorit ekonomik:

- Nga tabela e përqindjes së zënies së shtreterve dhe nga koeficenti i përdorimit të shtratit të pacientit mbi te cilën eshte percaktuar edhe nr. e shtreterve sipas te dhenave statistikore (bashkelidhur shkresa me Nr. 350 Prot, datë 12.04.2024 nga Sektori I Statistikës).

**Inventari qe është gjëndje, për materialin e butë sipas tabelës së treguar më poshtë:**

| Nr | Emertimi | Njesia | Sasia e inventarit | Jetegjatesia | Inventari qe duhet te zevendesohet dhe plotesohet menjehere me lidhjen e kontrates |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Dysheke | Cope | 193 | 5 vjet | Kjo sasi do të blihet vetëm nje here gjate gjithe kohezgjatjes se kontrates dhe do furnizohen sipas kerkeses se AK |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Çarcaf shtrati i poshtem | Cope | 193 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 3 | Çarçaf shtrati i siperm | Cope | 193 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 4 | Çarçaf zarf | Cope | 193 | 1 në dy vjet | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 5 | Kellef jasteku | Cope | 193 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 6 | Jestek krevati | Cope | 200 | 5 vjet | Kjo sasi do të blihet vetëm nje here gjate gjithe kohezgjatjes se kontrates dhe do furnizohen sipas kerkeses se AK. |
| 7 | Kemisha grash | Cope | 132 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 8 | Robdishan pacienti | Cope | 132 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 9 | Tranversa | Cope | 132 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 10 | Peshqire personeli | Cope | 240 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 11 | Jorgan me vatine | Cope | 193 | 5 vjet | Kjo sasi do të blihet vetëm nje here gjate gjithe kohezgjatjes se kontrates dhe do furnizohen sipas kerkeses se AK. |
| 12 | Mbulese dysheku e gomuar | Cope | 193 | 1 në dy vjet | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 13 | Pelena | Cope | 183 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 14 | Batanije bebesh | Cope | 122 | 5 vjet | Kjo sasi do të blihet vetëm nje here gjate gjithe kohezgjatjes se kontrates dhe do furnizohen sipas kerkeses se AK. |
| 15 | Batanije adult | Cope | 60 | 5 vjet | Kjo sasi do të blihet vetëm nje here gjate gjithe kohezgjatjes se kontrates dhe do furnizohen sipas kerkeses se AK. |
| 16 | Pandofla personeli | Cope | 240 | 1 ne dy vjet | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 17* | Carcafe salle me vrime | Cope | 120 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 18 | Kostume te ekipit te salles, jeshile | Pale | 180 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 19* | Carcafe tavoline dopje | Cope | 80 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 20 | Perparese mjeku | Cope | 118 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 21 | Kostume infermieri / personel ndihmes | Cope | 242 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |
| 22 | Kostume Sanitare | Cope | 120 | 1 ne vit | Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës |

**Shënim:** Per materialet me * në MK me afat 36 muaj nuk janë të përfshira pasi nga ana e AK nuk janë të nevojshme nga sherbimet e Spitalit Universitar Obstetrik – Gjinekologjik ”Koço Gliozheni” Tiranë.

**Përdorimi I materialeve si (jorgan, batanije):**

- Përzgjedhja e jorganëve me vatinë, bën të domosdoshme përdorimin e çarçafëve Zarf gjatë sezonit të vjesht-dimer. Gjatë sezonit të verës, lind domosdoshmërinë e mbulimit vetëm me çarçafë. Në këto kushte, është menduar që çarçafët zarfë të përdoren për 8 (tetë) muaj nga 16 Shatori deri me 14 Maj, ndërsa për periudhën nga 15 Maj deri në 15 Shtator do të përdoren çarçafë të thjeshtë, pra 4 (katër) muaj, për pasojë çarçafët e poshtem për shtratin do të përdoren për 12 muaj, ndërsa çarçafët e sipërm do të përdoren për 4 muaj, ndersa çarçafët zarf për 8 muajt e tjerë.
- Po keshtu perdorimi i batanijeve eshte i nevojshem jo vetem ne disa sherbime/pavione, si ne rastet postoperatore (ne dhomat e zgjimit), reanimacionet, urgjencat ,por edhe ne sherbimet e tjera .Pra perdorimi i tyre do te jete sipas nevojes/kerkeses nga sherbimet e **Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik”Koço Gliozheni” Tiranë**

**Shërbimi që kërkohet: Sherbimi i Lavanterise dhe Hotelerise ne Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik”Koço Gliozheni” Tiranë**

Operatori ekonomik privat që do të kontraktohet, duhet të ofrojë një shërbim i cili do të përfshijë:

- Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik”Koço Gliozheni” Tiranë, sipas grafikëve të përcaktuar, rregullave dhe protokolleve të higjenës dhe manualeve të kujdesit spitalor;
- Larjen e materialit të butë;
- Tharjen e materialit të butë:
- Hekurosjen dhe Paketimin e materialit të butë;
- Shpërndarjen e materialit të butë në të gjithë shërbimet e Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik”Koço Gliozheni” Tiranë, sipas grafikëve të përcaktuar;
- Shtrimin e shtratit të pacientit;

- Sigurimin e materialit të butë për shtratin e pacientit, personelin shëndetësor si dhe për sallat operatore sipas specifikimeve përkatëse;

Shërbimi do të ofrohet 24 ore gjatë 7 (shtate) diteve te javës, (operatori ekonomik duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në pavion, dhe shtrimin e shtratit të pacientit) sipas grafikut të përcaktuar për ndryshimin periodik të materialit të butë në shërbimet përkatëse, dhe sipas kërkesës së Kryeinfermiereve të pavionit në rast të ndryshimit të materialit të butë kur bëhet i domosdoshëm për pacientë të veçantë;

1. **Lloji i materialeve të buta për larje:**

Referuar standarteve dhe protokollove per sherbimet spitalore, në vijim jane të detajuara lloji i materialit të butë që do të lahet.

a. Per pacientet operatori ekonomik duhet te laje keto materiale te bute si ne vijim:

- Jorgan me mbushje me vatine, me tegela ndarëse në formë kuadrati, ngjyrë e bardhë. Pesha 2-2.3 kg. Veshja e jashtme e jorganit te jete pambuk, me permasa 140x180 cm.

- Jasteke me mbushje uniforme me fibra sintetike. Ngjyre e bardhe, me mbulese dyshe, me permasa 50x80 cm.Pesha 1kg
- Kellefe jastiku dy fletesh, me qepje nga te tre anet i care ne fund per te mundesuar futjen e jastikut ne forme zarfi, specifikimi 160-180 gr/m², me permasa 60 x 90 cm. Ngjyra e bardhe, Logo Spitalit SUOGJ “Koco Gliozheni” me qepje, pesha min 0.086kg - max 0.097 kg.
- Mbrojtese dysheku ,280 - 300 gr/m2 ,material pambuku ngjyrë e bardhë, i qepur nga të katër anët me llastik për t’u fiksuar tek dysheku spitalor, logo e spitalit pesha min 1,09 kg - max 1.17 kg. e gomuar, me përmasa 260 x 150 cm .
- Batanije Adulti , njëngjyreshe sipas kerkeses se AK. Kane te qepur Logon e SUOGJ “Koco Gliozheni” , me përmasa 140x 180cm, me material, material 60% lesh x40% akrilik.

- Batanije neonati , përmasat 150 x 90cm , ngjyra sipas kerkesave te AK. Logo Spitalit SUOGJ “Koco Gliozheni” me qepje.
- Çarçafe shtrati i siperm 160 – 180 gr/m2 Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë. Logo Spitalit SUOGJ “Koco Gliozheni” me qepje , pesha min 0.665 kg - max 0.748 kg me permasa 260x160cm, materiali 75% pambuk x 25% polyester,Lahet në temp 60°
- Çarçafe shtrati i poshtem me specifikime 160 – 180 gr/m2, Me qepje nga të katërta anët. Ngjyrë e bardhë. Logo Spitalit SUOGJ “Koco Gliozheni” me qepje , min 0.665 kg - max 0.748 kg ,160 x 180 gr/m2, me permasa 260x160 cm, materiali 75% pambuk x 25% polyester,Lahet në temp 60°
- Çarçafe zarf dy fletësh,me specifikime 160 – 180 gr/m2, me qepje nga të tre anët, i çarë në fund për të mundësuar futjen e jorganit ne forme zarfi. Ngjyrë e bardhë. Logo Spitalit SUOGJ “Koco Gliozheni” me qepje, pesha min 0.91kg - max 1.03 kg, materiali 100% pambuk
- Peshqire (per personelin) material 100% pambuku i butë ngjyrë e bardhë, 90x60 cm, Logo Spitalit SUOGJ “Koco Gliozheni” me qepje.

- Pelena me permasa 100cm X 100cm fanellat e bardhë me perberje100% pambuk. Pesha 0.10-0.12 kg
- Traversa me permasa 75x 90, fanellat e bardhë me perberje 100% pambuk . Pesha 0.10-0.12 kg
- Kemisha grash, te jete material 100% pambuk, me nr te ≠ sipas kerkesave te AK, një ngjyrësh. Logo Spitalit SUOGJ "Koco Gliozheni" me qepje.
- Robdisham paciente adulte. Me lidhje anesh ose mbrapa, me menge te shkurtera, te gjera, masa te ndryshme sipas kerkesave te AK .me specifikime 160 – 180 gr/m2 masat; M, L, XL, XXL, njëngjyrësh. Logo Spitalit SUOGJ "Koco Gliozheni", Pesha 0.3-0.324 kg.
- Pandofla salle me Nr. te ≠ Ngjyrë e bardhë, me vrima për ajrosje me shtresë ortopedike për qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë.Numrat, Sipas kerkesave te AK. Ngjyrë e bardhë, me vrima për ajrosje me shtresë ortopedike për qëndrimin për kohë të gjatë në këmbë, të jenë antirrëshkitës rezistentë ndaj grryerjes dhe vajit.

- Perparese mjeku ( Unisex ) Ngjyra e bardhë. Me mënge të gjata, me kopsa me perçina dhe 2 xhepa anash, me ngjyrën e bardhë me logon MSHMS dhe emërtesën e Spitalit SUOGJ "Koco Gliozheni" e qëndisur , pjesa e mbrapme me të care, material Përzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester. Larje ne 60°. Gjatësia e përparëses, sipas standartit S,M,L,XL,XXL
- Kostume infermier (neonati) , ( bluzë me pantallona unisex ) , (gjatë dimrit vishet bluzë e bardhë me mengë të gjata poshtë kostumit). Bluza me jakë V të trashë, me mengë të shkurtra ( tre çerekshe) me dy xhepa anësore poshtë, me ngjyrën sipas llojit të shërbimit me logon MSHMS dhe emërtesën e Spitalit SUOGJ ,"Koco Gliozheni" e qëndisur .

  **Infermier Pediatrie:** bluzë me kukulla dhe pantallona ngjyrëe bojëqielli.

  **Infermier , Reanimacion Pediatrie:** bluzë me kukulla dhe pantallona ngjyrë lejla e erret, bluza me jakë V të trashë, me mengë të shkurtra ( tre çerekshe) me dy xhepa anësore poshtë, me ngjyrën sipas llojit të shërbimit me logon MSHMS dhe emërtesën e Spitalit SUOGJ "Koco Gliozheni" e qëndisur.
- Kostume infermier salle operatore/blloku operator/ mami ( bluzë me pantallona unisex ) (gjatë dimrit vishet bluzë e bardhë me mengë të gjata poshtë kostumit) Bluza me jakë V të trashë, me mengë të shkurtra ( tre çerekshe) me dy xhepa anësore poshtë, me ngjyrën sipas llojit të shërbimit me logon MSHMS dhe emërtesën e Spitalit SUOGJ ,"Koco Gliozheni" e qëndisur .

  **Mami Shërbimi/Klinike** ngjyra bojë qielli i hapur.
  **Mami në Bllokun Operator** :ngjyra blue errët.
  **Infermier Reanimacioni:** Ngjyra jeshile e errët.
  **Embriologe :** bluzë me ngjyrë të bardhë dhe pantallonat ngjyre blu e errët.
- Kostume mjeku ( bluzë me pantallona unisex ) (gjatë dimrit vishet bluzë e bardhë me mengë të gjata poshtë kostumit), Bluza me jakë V të trashë, me mengë të shkurtra ( tre çerekshe) me dy xhepa anësore poshtë, me ngjyrën sipas llojit të shërbimit me logon MSHMS dhe emërtesën e Spitalit SUOGJ ,"Koco Gliozheni" e qëndisur .

  Mjek / Blloku Operator: ngjyra blu e errët. Mjek / Reanimacioni : Ngjyra jeshile e errët.

Sipas standartit S,M,L,XL,XXL. Përzierje 65% pambuk dhe 35 % polyester

